

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. HAJRIE MUÇMATA

11/11/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 07.11.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 11.11.2019, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Hajrie Muçmata, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Firdes Shuli, znj. Alma Faskaj relatores, znj. Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.